



Mësimi 8

Imazhet dhe Videot e Gjeneruara nga Inteligjenca Artificiale

Koha për përgatitje: 30 minuta Kohëzgjatja e modulit: 1 x 60 minuta

Abstrakt

Ky modul shqyrton përhapjen në rritje të imazheve dhe videove artificiale, duke u fokusuar në mënyrën se si krijohen, ndikimin që kanë në shoqërinë tonë dhe strategjitë për zbulimin e përmbajtjes së gjeneruar nga inteligjenca artificiale. Pjesëmarrësit do të analizojnë raste të njohura të medias së krijuar nga IA, do të zbulojnë teknika për të hedhur poshtë këtë përmbajtje dhe do të diskutojnë implikimet etike dhe morale. Qëllimi i këtij moduli është të forcojë aftësitë e edukimit mediatik dhe mendimit kritik të pjesëmarrësve në epokën e IA-së.

Burime edukative online

- Mësimi mbi Imazhet dhe Videot e Gjeneruara nga AI nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"
- Kuizi që mbulon aspekte të ndryshme të përmbajtjes së gjeneruar nga IA nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"
- Burime online për verifikim si: [TinEye](#), [Google Reverse Image Search](#), [FotoForensics](#), [InVID Verification Plugin](#), [Sensity](#).

Fjalë kyçe

*Media e Gjeneruar nga IA,
Deepfake,
Edukimi Mediatik,
Mendimi Kritik,
IA Etike*

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është t'u sigurojë pjesëmarrësve një mësim të plotë për kuptimin e imazheve dhe videove të gjeneruara nga inteligjenca artificiale, mënyrën se si krijohen dhe implikimet shoqërore që ato sjellin. Synimi është të përmirësojë aftësitë e mendimit kritik dhe edukimit mediatik të pjesëmarrësve duke i mësuar si të zbulojnë mediat e gjeneruara nga IA, të vlerësojnë autenticitetin e tyre duke përdorur mjete dhe metoda të ndryshme, dhe të mendojnë për pasojat etike të përdorimit të tyre. Kuptimi i teknologjisë së IA-së është thelbësor për të naviguar në një botë digjitale gjithnjë e më shumë të ndikuar prej saj, dhe ky modul ndihmon në mundësimin e ndërveprimeve të informuara dhe përgjegjëse me këtë lloj materiali mediatik.

Rezultati i modulit

Pjesëmarrësit do të mësojnë se si prodhohet dhe konsumohet media e gjeneruar nga IA, si dhe si të njohin dhe verifikojnë përmbajtjen artificiale përmes analizës kritike dhe mjeteve digjitale. Ata do të shqyrtojnë disa çështje etike si keqinformimi dhe privatësia lidhur me përdorimin e IA-së, do të aplikojnë aftësitë e reja të fituara për të vlerësuar autenticitetin dhe do të angazhohen në diskutime të informuara mbi ndikimet e medias së gjeneruar nga IA në shoqërinë e sotme.

min. 1 - 5: Hyrje

- Angazhoni pjesëmarrësit dhe prezantoni temën duke bërë pyetje të përgjithshme lidhur me temën.
- Shembull: Një pyetësor në Mentimeter: “A keni hasur ndonjëherë në një imazh ose video të gjeneruar nga AI? Nëse po, ku?”
- Shfaqni shembuj të tillë të medias së gjeneruar (video deepfake, art i gjeneruar nga AI).

Prezantoni temën dhe përshkruani qëllimet e mësimit.

min. 6 - 20 : Aktivitet ndërveprues

- Shpjegoni Diskutimin: Rastet e njohura të medias së gjeneruar nga AI:
 - Video DeepFake të Tom Cruise në TikTok
 - Vepra arti të gjeneruara nga AI që fitojnë konkurse
 - Video e rreme e fushatës së Kamala Harris
- Përshkruani mjetet dhe teknologjitë e zakonshme të përdorura në përmbajtjen e gjeneruar nga AI, si modelet Deepfake dhe DALL-E 2.
- Drejtoni biseda në grupe të vogla mbi mënyrën se si këto teknologji ndikojnë në shoqëri (keqinformimi, potenciali krijues, çështjet e të drejtave të autorit).

min. 21 - 50: Aplikim Praktik

- Ushtro identifikimin e përmbajtjes së gjeneruar nga IA:
- Krahaso media autentike me atë të gjeneruar nga IA.
- Analizo videot e rreme që tregojnë parregullsi (në ndriçim, simetri dhe metadata).
- Debato dilemat etike:
- “A duhet që imazhet e gjeneruara nga IA të etiketohen për t’u dalluar nga ato autentike?”
- “A ul arti i gjeneruar nga IA vlerën e krijimtarisë njerëzore?”
- Nxënësit praktikojnë përdorimin e mjeteve online (p.sh., TinEye, FotoForensics) për verifikimin e imazheve dhe videove.
- Organizo një kuiz në Kahoot që fokusohet në çështjet etike dhe aspektet kryesore të zbulimit të medias së gjeneruar nga IA.

min. 51 - 60: Përfundime

- Rikapitulloni pikat kryesore: Mjetet dhe metodat; Çështjet etike. Inkurajoni pjesëmarrësit të vazhdojnë praktikimin e verifikimit të medias duke përdorur mjetet.
- Pyetje reflektuese me theks në atë që duhet të mbajnë mend nga ky mësim, si p.sh.:
- Si mund t’ju ndihmojnë këto aftësi në jetën e përditshme?
- Si planifikoni të përdorni median e gjeneruar nga IA?

Materiale/ Mjete

Projektor video; laptop/kompjuter desktop; lidhje interneti; shembuj të imazheve dhe videove të gjeneruara nga IA; qasje në mjete verifikimi (p.sh., TinEye, InVID); qasje në Moodle; prezantim në PowerPoint/Prezi i pasuruar me materiale vizuale (imazhe dhe klipe video) dhe informacione faktuale të bazuara në kërkime.